



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 137

Prishtinë, më 4.2.2014, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Daut Haradinaj, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Boban Todorović, Ramiz Lladrovci.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 28.1.2014,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime duke arsyetuar kryetari urgjencën e mbledhjes për shkak të largimit të fjalëve nga rruga në favor të institucionalizimit të çështjes konkrete.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.1.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 28 janar 2014, duke konstatuar vërejtjen e përgjithshme të **Daut Haradinaj** se për temat me rëndësi, stafi duhet të jetë më vigjilentë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Kryetari Nait Hasani përshëndeti anëtarin e ri të Komisionit nga VV Faton Topallin-nënkryetarin e parë të Komisionit dhe të pranishmit dhe përsëriti edhe njëherë arsyen e thirrjes së mbledhjes brenda kohës së shkurtë, për shkak të ikjes nga fjalët që gjatë këtyre ditëve zhvillohen

në rrugë, pra të vendosjes së kësaj çështje në binar institucional pasi është bërë leximi i parë në Kuvend i këtij projektligji, ndaj fillimisht propozoi që rreth këtij projektligji mos të shqyrtohen menjëherë vërejtjet por të organizohet një dëgjim publik. **Daut Haradinaj** ndërhyri rreth shqyrtimit me GP apo Komisioni komplet, ndërkaq kryetari sugjeroi Komisionin komplet. **Rasim Demiri** propozoi të bëhen vizita në bashkësitë fetare pastaj dëgjimi të organizohet.

Salih Morina arsyetoi këtë takim ngase në opinion ka mjaft mosinformim rreth projektit në fjalë, megjithëse sipas tij do të ishte ndoshta më mirë që kjo çështje të rregullohet me Ligjin për Bashkësitë fetare ose Ligji për religjionet. Artikulli 4.2. i projektligjit rreth pajisjeve akustike të objekteve fetare, në opinion ka zgjuar interesim, ndaj kjo është arsye e mjaftueshme për të organizuar dëgjimin por në të cilin bashkësitë fetare duhet të angazhohen dhe të japin kontributin e tyre, në mënyrë që në fund të hartohet amendamenti për të cilin do të votoi parlamenti.

Faton Topalli gjithashtu arsyetoi mbajtjen e dëgjimit publik, ngase degradimi i projektligjit ka ndodhë pikërisht për shkak të arsytimit jo të mirë (vërejtjet nga mediat, sidomos në gazetën EXPRES), ndaj debati duhet të sqaroi se ky ligj nuk ka të bëjë me ezanin apo kambanat e kishës.

Sevdije Lama arsyetoi diskutimet dhe njoftoi për qëndrimin e KKR se MMPH është ajo e cila duhet të tërheq Nenin (paragrafin 4.2.) që atakohet.

Daut Haradinaj bëri apel për syqeltësi ngase ligji është me elemente të rëndësishme, komisioni duhet të konsultohet me bashkësitë fetare. Ky projekt në asnjë vend nuk përmend xhami ose kishë, paragrafi kontestues 4.2 flet për zhurmë të jashtëm. Jam kundër atyre, vazhdoi ai, që sulmojnë aq lehtë institucionet (sidomos deputeti Ahmeti) dhe këto tendenca për fyerje duhet të parandalohen, edhe pse në këtë rast ka gabime edhe në anën e ekzekutivit e cila ka treguar pakujdesi. Edhe poçes hiqet neni i atakuar, vazhdoi, gjë që mendoi se nuk dëmtohet ligji nëse ndodhë kjo, komisioni duhet të debatojë rreth vërejtjeve të deritanishme nga GP 6+, deputeti Amir Ahmeti dhe deputetja Biserka Kostiq të cilët atakojnë paragrafin e lartcekur. Gjithashtu ai shtoi se sot në media flitet për takimin në mes ekzekutivit dhe bashkësisë përkatëse fetare, por asgjë nuk është konkrete çka janë marr vesh. Ministri përkatës ka dërguar projektligjin në Kuvend, prandaj ai nuk ka kompetenca më në këtë drejtim, ngase Kuvendi është ai që tani duhet të vendos. Ky ligj nuk i takon fesë dhe nuk duhet të politizohet. Ministri nëse ka ende diçka të shtoi rreth këtij ligji, duhet të vjen këtu në komision, sepse jemi shtet ligjor.

Boban Todoroviq mbështeti propozimin për dëgjimin publik ku do të ftohen faktorët relevant dhe mbështeti deputetin Daut për arsyetimin sa më të mirë çka paraqet ky ligj.

Ramiz Lladrovci fillimisht kundërshtoi thirrjen në këtë mënyrë të mbledhjes urgjente ngase nuk ka pasur arsye, ndërkaq lidhur me nenin e atakuar të projektligjit mendon se nuk ka nevojë për amendamentim ngase aty kemi të bëjmë me zhurmën e madhe që shkaktohet nga altoparlanta të ndryshëm.

Afërdita Berisha patjetër tha se duhet të bëhet dëgjimi publik në mënyrë që mos të reflektohet se jemi kundër ezanit apo këmbanave, ngase ato nuk mund të trajtohen si zhurmë. Gjithashtu edhe **Salih Morina** shtoi se Ministri i mjedisit ka shkuar me vonesë tek bashkësia fetare, ndaj konsultimet dhe punët tjera tani i takojnë komisionit parlamentar. **Nait Hasani** potencoi se deri tani janë parashtruar disa vërejtje me shkrim dhe ato ende mund të parashtrohen nga qeveria apo të interesuar tjerë, qytetar etj, ndaj sugjeroi të veprohet sipas sugjerimeve të shumicës së anëtarëve të komisionit, fillimisht të caktohet dëgjimi publik. **Ramiz Lladrovci** tha se Qeveria (MMPH) nuk ka drejt të amendamentoj por të mbrojë atë çka ka dërguar (projektligjin) si dhe komisioni duhet sot të propozoi kush të ftohet, e jo gjithkush. **Salih Morina** shtoi se duhet të ftohen institucionet përgjegjëse, bashkësitë fetare, shoqëria civile etj, për të sqaruar me kompetencë se a duhet të qëndroi ky nen apo jo. Gjithashtu pohoi atë çka tha kryetari se Ministria ka drejt të amendamentoj projektligjin. **Daut Haradinaj** potencoi se para vizitave duhet të ju dërgohen bashkësive nga një kopje të projektligjit në mënyrë që mos të krijohet përshtypja që po shqyrtohen çështjet fetare, ngase fjala është vetëm për zhurmë.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Dëgjimi publik rreth projektligjit për mbrojtjen nga zhurma mbahet të mërkurën më 12.2.2014 në orën 13,00 ku do të ftohen faktorët relevant të propozuar nga komisioni.

2. Të vizitohen bashkësitë fetare (islame, katolike dhe ortodokse) ditën e hënë dhe martë (më 10 dhe 11 shkurt) nga komisioni ose nga një grup më i vogël të anëtarëve të komisionit, duke u konsultuar kryetari lidhur me këto takime dhe duke ju dërguar bashkësive fetare nga një kopje të projektligjit para se të bëhen vizitat.

Mbledhja përfundoi në orën 14,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani